



NJOFTIM MBI VENDIMIN E BORDIT TË DREJTORËVE TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

**LIRIMI I NJËSISË PUNUESE TË NDËRMARRJES PEJ058 “UNIFARM”- PEJË NGA KOMPETENCAT DHE
AUTORITETI ADMINISTRATIV I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

Bazuar në nenet 5, 6 dhe 15 të Ligjit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2013 ka vendosur që njësia punuese e ndërmarrjes “Sanitas/Unifarm” me seli në Pejë është aset i ndërmarrjes shoqërore.

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij Ligji, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2014 ka vendosur për fillimin e procedurës së likuidimit dhe ka bërë emërimin e Autoritetit përkatës të Likuidimit për PEJ058 NSH “Unifarm” në Pejë më 16 qershor 2014.

Bazuar në Aktgjykimin të lëshuar nga Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, vërtetimit të tij nga ana e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, janë anuluar vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 31 tetor 2013 mbi përcaktimin e statusit juridik të kësaj njësie punuese të ndërmarrjes shoqërore dhe të datës 7 maj 2014 për fillimin e procedurave të likuidimit, dhe është vendosur se njësia punuese në fjalë është ndërmarrje private SH.A. “Unifarm”- Pejë me seli në Podgoricë, Mal të Zi.

Bazuar në Aktgjykimet e lartpërmendura të lëshuara nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe në nenin 15 paragrafin 2.17 të Ligjit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 30 Janar 2019 bazuar ka vendosur që të liroj nga kompetencat dhe autoriteti administrativ i Agjencisë Kosovare të Privatizimit si dhe ka anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra nën prezumimin e autorizimeve administrative dhe kompetencave të AKP-së ndaj njësisë punuese të ndërmarrjes PEJ058 “UNIFARM” në Pejë.